

## Mbledhje e Komitetit Teknik

### KT 275: “Rishikimi i standardeve puro shqiptare S SH është kërkesë e kohës”



mirë të mbledhjes së komitetit, sekretari shqiptare te këtyre viteve.

Në ambientet e DPS-së më, 25.11.2010 është mbajtur mbledhja e KT 275 për shqyrtimin e disa standardeve puro shqiptare, si dhe rishikimin e mundësisë së organizimit të Komiteteve Teknike të fushës së ushqimit.

Fillimisht sekretari i KT 275 Z. Riza Hasanaj njohu pjesëmarrësit me kërkesën e Laboratorit të Doganës për rishikimin e disa standardeve të pastra shqiptare S SH të cilat janë të vitit 1987. Për një mbarëvajtje të kishte hartuar listat e plota me standardet

Në fjalën e saj Kryetarja e KT 275, Znj. Ilirjana Boçi, vlerësoi kërkesën e bërë nga Laboratori i Doganës, kërkesë e cila përputhet dhe me mendimin e saj që ka ardhur koha e rishikimit të standardeve të pastra shqiptare S SH për faktin se tashmë Shqipëria është në një fazë tjetër zhvillimi dhe ka detyrime më të mëdha në kuadër të kërkesës për të marrë statusin e vendit kandidat në Bashkimin Europian.

Pas diskutimesh të shumta u vendos që rishikimi i standardeve S SH të bëhej me grupe duke filluar së pari nga standardet e metodave të analizave për nga vetë rëndësia e tyre dhe në një kohë të dytë të vazhdohej me standardet e karakteristikave të produktit. Në mbledhje ju la detyrë sekretarëve të këtyre KT të identifikojnë dhe të nxjerrin në formë elektronike standardet S SH të metodave të analizave dhe në krah të tyre të gjejnë standardet europiane ose ndërkombëtare që ata mendojnë se mund të zëvendësojnë SSH. Në bashkëpunim me kryetarët të hartojnë listat përfundimtare të standardeve që do të rishikohen dhe ti bëjnë ato gati për planin e punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 që do ti paraqitet Grupit të Ekspertëve (GES) për miratim.



Lidhur me një organizim më të mirë të KT në fushën e ushqimit sekretari i KT 307 “Vajra dhe yndyrna ushqimore. Fara vajore” Z. Pëllumb Metohu propozoi mundësinë e bashkimit të këtij komiteti me KT 275.

Në diskutimin e tij z. Riza Hasanaj argumentoi sepse këto komitete nuk duhet të bashkoheshin por do të funksiononin të ndarë. Në fund edhe anëtarët e tjerë ranë dakort që të mos bëhej ky ndryshim.

Për një organizimi më të mirë të bashkëpunimit dhe shkëmbimin përvojës midis anëtarëve dhe u la detyrë që të tërhiqeshin sa më shumë specialistë të tjerë për të dhënë kontributin e tyre në këtë fushë

**Pjesëmarrja:**

Ilirjana Boçi	Kryetare
Riza Hasanaj	Sekretar
Pëllumb Metohu	Anëtar
Mirela Domi	Anëtare